

HUAZIMET NË POEZITË “DUKE PRITUR TY”, “KINEMA E VJETËR”, “KUR TI TELEFONOJE”, “PRITJA”, “RETË”, “KOHA E POPUJVE” TË ISMAIL KADARESË

Donika BAKIU¹

^{1*} Department of Culture, Sector of Public Activity, Municipality of Tetova

^{*}Corresponding author e-mail: donikabaku93@gmail.com

Abstract

Ismail Kadare is one of the greatest contemporary writers. In this paper, we have found the borrowings that the author Ismail Kadare uses in some of his poems that we have taken for study. The phenomenon of borrowing is well accepted by everyone and is often seen as a necessity in communication, but only to the extent that it is used logically. and for the benefit of communication and the enrichment of the language, without abusing this freedom that each speaker has and damaging the language by introducing foreign words here and there. The borrowings we found are: asphalt, xhami, sahat, vërtit, stol, barakë, kadife, pazar, hamall, kolltuk, xham, josh, abazhur, qilim, dremit, vatan, kob, batak, oxhak.

Keywords: borrowings, poetry, writer, linguists, Indo-European.

Përmbledhje

Ismail Kadare është një nga shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë. Në këtë punim kemi gjetur huazimet që autori Ismail Kadare përdor në disa nga poezitë e tij që kemi marrë për studim. Fenomeni i huazimit pranohet mirë nga të gjithë dhe shpesh shihet si një domosdoshmëri në komunikim, por vetëm në masën që përdoret logjikisht. dhe në dobi të komunikimit dhe pasurimit të gjuhës, pa abuzuar me këtë liri që ka çdo folës dhe duke e dëmtuar gjuhën duke futur fjalë të huaja aty-këtu. Huazimet që gjetëm janë: asphalt, xhami, sahat, vërtit, stol, barakë, kadife, pazar, hamall, kolltuk, xham, josh, abazhur, qilim, dremit, vatan, kob, batak, oxhak.

Fjalët kyçe: huazim, poezi, shkrimtar, gjuhëtarë, indoevropiane.

1. Hyrje

Ismail Kadare është një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë. Si shkrimtar shquhet kryesisht për prozë, por ka botuar edhe vëllime me poezi dhe ese. Nisi të shkruajë kur ishte i ri, fillimisht poezi, me të cilat u bë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar. Deri më sot veprat e tij janë përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe nëpër botë. Në këtë punim kemi gjetur huazimet të cilat autori Ismail Kadare përdor në disa poezi të tij që ne kemi marrë për studim. Huazim quhet fjalë a njësi tjetër gjuhësore, që është marrë prej një gjuhe tjetër dhe përdoret në gjuhën amtare. (Baku, 2019).

Dukuria e huazimit është e mirëpranuar nga të gjithë dhe shihet shpesh herë si domosdoshmëri në komunikim, por deri aty ku kjo përdoret me logjikë dhe në dobi të komunikimit e pasurimit të gjuhës, pa shkuar në shpërdorim të kësaj lirie që ka secili folës dhe të kalojmë në dëmtim të gjuhës me futjen e fjalëve të huaja vend e pa vend. Huazimi ka ardhur si nevojë e njerëzimit për të komunikuar mes folësve të shteteve të ndryshme. Huazimet turke kanë nisur që në gjysmën e dytë të shekullit XIV dhe janë bërë më të dendura pas pushtimit të trevave shqiptare nga turqit. Gjuha jonë është gjuha e një populli që ka luftuar shumë për të mbijetuar dhe për të ruajtur kufijtë e tij territorialë, njëkohësisht për të ruajtur edhe gjuhën si një element identiteti kombëtar. Për ta arritur këtë është bërë një punë shumëvjeçare nga shkrimtarë, studiues, gjuhëtarë e dashamirës të shqipes.

2. Huazimet në poezitë “Duke të pritur ty”, “Kinema e vjetër”, “Kur ti telefonoje”, “Pritja”, “Retë”, “Koha e popujve” të Ismail Kadarese

Në poezinë “**Duke të pritur ty**” i gjetëm këto huazime:

Si re të bardha që notojnë mbi asphalt./ Tek xhamia,/Përballë sahatit unë rri./Rrotull sahatit vërtiten, të bardhë, të bardhë.

Asfalt - bitum. Fjalë e huazuar, që mund të ketë hyrë nga burime të ndryshme prej gjuhëve romane. Burim është greqishtja, ku fjala ka origjinë semitike.

Xhami - ndërtesa ku bëhen shërbesat fetare të myslimanëve. Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga turqishtja me burim prej arabishtes.

Sahat - orë. Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga turqishtja me burim prej arabishtes.

Vërtit - e sjell rrotull, e rrotulloj. Huazim prej gjuhëve sllave.

Në poezinë “**Kinema e vjetër**”, i gjetëm këto huazime:

Stolat janë boshe si radhë të pashkruara./ Këtë poemë stolash të gjatë, të braktisur/E shtrenjta barakë./ As në sallat luksoze me kadife që shndrit,/ Afishet tek xhamia/Dhe tek Qafë e Pazarit/Stola ku janë ulur varg /Stola të rëndë, të gjatë, të vithisur./Si hamall këto stole /Do t'i marr me vete.

Stol - ndenjësë e ulët pa shpinëz për një njeri ose për shumë njerëz. Huazim nga gjuhët sllave.

Barakë - ndërtesë e vogël prej dërrase ku strehohen njerëz a materiale. Huazim nga italishtja baracca, që ka si burim spanjollishten barraca=kësollë barinjsh, fjalë me origjinë pararomake.

Kadife - lloj pëlhure e trashë, e endur me fije mëndafshi. Huazim nga turqishtja me burim prej arabishtes.

Xhami - ndërtesa ku bëhen shërbesat fetare të myslimanëve. Fjalë e mbarë gjuhës. Huazim nga turqishtja me burim prej arabishtes.

Pazar - treg. Fjalë e mbarë gjuhës, e vjetëruar. Huazim prej turqishtes me burim prej persishtes.

Hamall - punëtor ngarkim-shkarkimi. Huazim nga turqishtja me burim prej arabishtes.

Në poezinë “**Kur ti telefonoje**”, i gjetëm këto huazime:

Në **kolltukun** e palëvizshëm pranë vetmisë./ U afrova tek **xhamat**./ Pa u ndalur e pa u pleksur me ylberët **joshës** rrugës.

Kolltuk - ndenjësë e veshur dhe e butë. Huazim prej turqishtes kolltuk nga kol –krah me kuptimin karrige me krahë. Ka hyrë edhe në gjuhë të tjera ballkanike.

Xham - qelq, gotë e qelqtë, tas i thellë. Huazim nga turqishtja cam me burim prej persishtes.

Josh - e tërheq me dhelka. Huazim prej turqishtes hos-sh, i këndshëm, i pëlqyeshëm, me burim prej persishtes.

Në poezinë **“Pritja”**, i gjetëm këto huazime:

Abazhuret varen të heshtur mbi pritjen/përbindëshat mbi **qilimin** e dhomës **dremitin** të qetë/ drita e **abazhureve** u bë e keqe/ja, po zgjohen me leshra të kërleshura mbi **qilim**/.

Abazhur - mbulesë qelqi a metali për llamba elektrike, kësulë llambe. Huazim i ri nga gjuha frenge.

Dremit - fle pak duke ndenjor, kotem. Huazim prej gjuhëve sllave.

Qilim - shtrojë e endur me lesh e pambuk. Huazim nga turqishtja kilim me burim prej persishtes.

Në poezinë **“Retë”**, i gjetëm këto huazime:

“Veç retë që vinin që larg nga **vatani** e panë dhe e njohën e zunë të qanin.”

Vatan - atdhe, vendlindje. Huazim nga arabishtja që ka hyrë nëpërmjet turqishtes.

Në poezinë **“Koha e popujve”**, i gjetëm këto huazime:

Me brirë të tmerrshëm e klithma **kobi**/ ngecnin përbindëshat në **batak**/ **oxhakët** nxijnë lart.

Kob - mjerim i madh, mënxyrë, mashtrim, pabesi. Huazim prej gjuhës bullgare.

Batak - vend me baltë me ujë. Huazim nga turqishtja batak-ligatë, pellg.

Oxhak - vendi ku ndizet zjarri e del tymi jashtë, vatër e mbjellë me bostan a oriz, familje e vjetër, derë e madhe. Huazim prej turqishtes.

3. Përfundim

Një tipar i përbashkët që i shquan gjuhët e Ballkanit nga gjuhët e tjera indoevropiane të kontinentit, është edhe prania e një shtrese fjalësh të ardhura nga turqishtja, të cilat disa studiues i quajnë thjesht turqizma e disa orientalizma, meqë një pjesë e mirë e tyre janë me burim nga arabishtja e nga persishtja dhe turqishtja ka qenë vetëm gjuha ndërmjetëse. (Lafe, nr.1-4, 1993). Huazimet greke dhe huazimet turke kanë hyrë në gjuhën shqipe në kohë të ndryshme. Depërtimii i huazimeve është bërë në periudhë të gjatë kohore dhe detyrimisht kanë hyrë në çdo sektor të jetës shqiptare. Në këtë punim gjetëm huazimet të cilat Ismail Kadare përdor në disa poezi të tij. Huazimet që gjetëm janë: asfalt, xhami, sahat, vërtit, stol, barakë, kadife, pazar, hamall, kolltuk, xham, josh, abazhur, qilim, dremit, vatan, kob, batak, oxhak.

Referencat

- [1]. Bakiu Donika. (2019, 4 12). infoshqip. Retrieved 9 8, 2020, from <https://www.infoshqip.com/gjuha-shqipe-dhe-huazimet-greke/>
- [2]. Bozarslan Hamit, (2007), Histoire de la Turquie contemporaine, Paris, La Découverte, « Repères Histoire, 123 pages.
- [3]. Buda, Aleks 1980, “Rreth disa çështjeve të historisë së formimit të popullit shqiptar, të gjuhës e të kulturës së tij”, Studime historike, 171.
- [4]. Demiraj Shaban, 1988. Gjuha shqipe dhe historia e saj, SHBLU, Tiranë, f. 125, 126
- [5]. Lafe Emil. (nr.1-4, 1993). Vendi i orientalizmeve ndër huazimet e shqipes. Studime filologjike, 35.
- [6]. Topalli, Kolec. ,2017. Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike
- [7]. <https://fjalashqip.com/ismail-kadare-duke-te-pritur-ty/>